

LIGJ

NR. / / 2022

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 22/2018 “PËR STREHIMIN SOCIAL”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Në nenin 2 “Përkuftimet” bëhen ndryshimet si vijon:

1. Pika 44 ndyshohet si vijon:

“44. Të ardhura familjare” janë të ardhurat periodike që siguron familja nga pagat, veprimtaria ekonomike, interesat e depozitave bankare, të ardhura nga persona të tretë, qiratë nga prona të paluajtshme. Në këto të ardhura nuk përfshihen të ardhura nga ndihma ekonomike, pagesat e papunësisë, pagesat që marrin pjestarët e familjes që kujdesen për personin me aftësi të kufizuar dhe “pagesat që marrin pjestarët e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror; përsitimet e personave me aftësi të kufizuara sipas statusit të invalidit të punës ose të luftës; përsitimet nga ndihma ekonomike për shkak të aftësisë së kufizuar, e parashikuar në legjislacionin mbi ndihmën dhe shërbimet shoqërore, legjislacioni mbi statusin e të verbit dhe legjislacioni mbi statusin e invalidit paraplegjik e tetraplegjik; përsitimet nga rimbursimi i shpenzimeve për energji elektrike, nga rimbursimet për ilaçë e mjekime për të sëmurët kronikë dhe nga paketa higjieno-shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara.

2. Pas pikës 51 shtohet pika 52 dhe 53 si vijon:

“52. “Lagje të varfëra (Slums)”, janë zona të banuara, të përbëra nga më shumë se 10 banesa, ku banorët vuajnë nga privimi i një a disa kushteve të përshtatëshme të banimit, sipas përcaktimeve në nenin 4 të këtij ligji.

“53. “Monitorimi”, do të thotë mbikëqyrja e realizimeve të investimeve për programet sociale të strehimit me financime ose bashkëfinancime nga buxheti i shtetit dhe ky monitorim kryhet nëpërmjet analizës së raportimeve standarde mujore që dërgohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe/ose vizitave në terren.

Neni 2

Pika b e nenit 11 togjalëshi “*deri në ndërtim të ri*” zëvendësohet me “*dhe lagje të varfëra*”.

Neni 3

---

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 22/2018 “PËR STREHIMIN SOCIAL”**

Pikat 1 dhe 2 të nenit 14 ndryshojnë në përbajtje si vijon:

1. Përfshirja në programet sociale të strehimit bëhet nëpërmjet kërkesës në sistemin e-Albania që ngrihet me vendim të Këshillit të Ministrave i propozuar nga ministri përgjegjës për strehimin.
2. Personat që nuk kanë mundësi aksesi në sistemin e-Albania, i drejtohen qendrave one stop shop, pranë njësisë së vetqeverisjes vendore ku kanë vendbanimin.
3. Dokumentacioni i nevojshëm që mbështet aplikimin për strehim, gjenerohet nga sistemi pa pagesë, përfshirë edhe vërtetimet negative nga ASHK.

#### Neni 4

Në nenin 15 bëhen ndryshimet si vijon:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me përbajtje si vijon:

“1/1. Sistemi i pikëzimit në total duhet të përbajë 100 pikë, ku çdo kriter i përcaktuar në nenin 16, përmban 25 pikë. Mënyra e shpërndarjes së pikëve brënda kritereve bëhet nga vëtë njësia e vetqeverisjes vendore.”

2. Pika 3 shfuqizohet.

3. Pas fjalisë së fundit të pikës 5, shtohen fjalitë me këtë përbajtje;

“Për efekt të aplikimit përfundimtare e cila publikohet pranë NJVV-së përkatëse dhe i dërgohet ministrisë përgjegjëse për strehim. Ministria përgjegjëse në bazë të fondeve në dispozicion dhe kërkesave në rang vendi përcakton fondin për cdo bashki, dhe ua dërgon njësive të vetqeverisjes vendore. Pas alokimit të fondit, dhe buxhetit takues këshilli i njësisë së vetqeverisjes vendore miraton listën përfundimtare e cila publikohet pranë NJVV-së përkatëse.

Pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përbajtje:

“6. Mos publikimi i listës pranë NJVV përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjybë sipas pikës b të nenit 75/1 të këtij ligji. Familjet e listës paraprake, që nuk arrijnë të përfitojnë strehim, ngelen në listë pritje për:

- a) t'u trajtuar me një program tjeter kur ato nuk mund të përballojnë kostot e programit për të cilin janë miratuar, ose
- b) për tu trajtuar në vitin pasues, kur fonda janë të pamjaftueshme”.

#### Neni 5

Në nenin 16 bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Përbajtja e nënndarjes iv) të shkronjës b) riformulohet si vijon:

“iv)-b familje të reja, kur, në momentin e aplikimit, mosha e anëtarit më të madh është më e vogël ose baraz me 38 vjeç.

2. Pas nënndarjes iv) shtohet nënndarja v) me këtë përbajtje:

“v) Të rinj, që në momentin e aplikimit kanë një moshë jo më të madhe se 38 vjeç”

3. Nënndarja “i” e germës “c” riformulohet si vijon:

“i. personat me aftësi të kufizuara, sipas pikës 28 të nenit 2 të këtij ligji.”

## Neni 6

Në nenin 19 ndryshon në titull si vijon "Kontributi i sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale", dhe bëhen këto shtesa e ndryshime:

### 1. Pika 1 riformulohet si vijon:

"1. Çdo subjekt privat që, pas datës 30 Nëntor 2018, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për objekte me sipërfaqe ndërtimi mbi 2 000 metra katrorë, siguron kalimin pa shpërbllim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes së ndërtimit shtesë mbi 2 000 metra katror, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Në rastin kur sipërfaqja e përfituar nga zbatimi i nenit 19 të këtij ligji, nuk i plotëson kushtet dhe normat e strehimit për banesat sociale, subjekti detyrohet të sigurojë një apartament sipas normave në një zonë tjetër.

### 2. Pas pikës 2 shtohen pikat 3, 4 dhe 5 si vijon:

"3. Mënyra e raportimit, llogaritjes, përfitimit dhe zbatimit të këtij nenit përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

"4. Në zbatim të këtij nenit, NJVV ka detyrim të njoftojë 1 herë në vit, ministrin përgjegjës për-strehimin, mbi-fondin-publik-të-banesave-sociale-të-krijuar-në-zbatimi-i-këtij-neni-si-dhe-numrin-e-familjeve-përfituese.

"5. Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) dhe Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit (AQTN), informojnë periodikisht, por jo më pak se 2 herë në vit, Ministrin përgjegjës për strehimin, mbi lejet e ndërtimit për objektet e banimit mbi 2,000 m<sup>2</sup> të depozituara në IKMT dhe lejet e shfrytëzimit të depozituara në AQTN, sipas formatit që miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

## Neni 7

Në nenin 25, bëhen këto ndryshime e shtesa:

### 1. Pika e parë numërohet me numrin 1.

### 2. Pas pikës 1, shtohet pika 2 me këtë përbajtje:

"2. Bashkia nëpërmjet buxhetit të saj ose me bashkëfinancim me buxhetin e shtetit, mund të financojë për riparimin e banesës në pronësi të pronarit social, kur vlera e investimit nuk është më shumë se 30% e kostos së ndërtimit të një objekti të ri dhe jo më shumë se 800,000 lekë. Në rast se banesa ka nevojë për një vlerë më të madhe investimi, diferenca mund të paguhet nga pronari social në mënyrë të menjëherëshe ose me këste sipas marrëveshjes që lidhet midis tij dhe bashkisë. Masë vjetore e qirasë llogaritet duke zbritur nga qiraja reale 1/10 e vlerës së investimit. Kontrata midis bashkisë dhe pronarit social në këtë rast, lidhet me një afat më të gjatë se 5 vjet. Në rast se kontrata prishet në mënyrë të njëanëshme nga pronari social, ky i fundit detyrohet të kthejë shumën e investuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore, minus pjesën që i është zbritur nga qiraja.

## Neni 8

Në nenin 30 bëhen këto ndryshime e shtesa si më poshtë:

1. Pikit 4, 5 e 6 ndryshojnë si vijon:

“4. Për banesat sociale me qira që përftohen nga adaptimi i objekteve të dala jashtë funksioni, sipas përcaktimit të shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 17, të këtij ligji, masa e qirasë përcaktohet nga këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas pikës 3, të këtij nenit, bazuar në vlerën kapitale të transferuar dhe kostot e ndërhyrjes përshtatjen e tyre.

5. Kur banesat sociale me qira sigurohen sipas nenit 19 të këtij ligji dhe shkronjës “a” të pikës 2 të nenit 52 të këtij ligji, masa e qirasë sociale përcaktohet sa 3% e llogaritur mbi koston e ndërtimit që miratohet me udhëzim të Këshillit të Ministrave sipas shkronjës “dh” të nenit 72 të këtij ligji.

6. Kur banesa sociale me qira sigurohet sipas shkronjës “c” të pikës 2 të nenit 52 të këtij ligji, masa e qirasë sociale llogaritet sa 3% e kostos së financuar a bashkëfinancuar.”

2. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1 si vijon:

“6/1. Kur banesa sociale me qira, sigurohet sipas shkronjës “b”, të pikës 2 të nenit 52 të këtij ligji masa e qirasë përcaktohet në marrëveshjen që lidhet midis subjektit që ka financuar dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe miratohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku zbatohet projekti. Masa e qirasë, e shprehur në lekë për metër katror, si rregull, mbulon kostot për administrim, mirëmbajtje, kosto operacionale dhe kosto të investimit ose të shlyerjes së borxhit. Niveli i qirasë sociale nuk duhet të jetë më i lartë se 80% i nivelit mesatar të qirasë së banesave në treg, sipas pikës 36 të nenit 2 të ligjit.”

Neni 9

Shkonja d) e pikës 1 të nenit 31 ndryshon si më poshtë:

“d) të ardhurat e qiramarrësit tejkalojnë ato të përcaktuara në pikat 1 e 2 të nenit 20, të këtij ligji. Në këtë rast, njësia e vetëqeverisjes vendore mund t'i ofrojë familjes lidhjen e një kontrate sipas pikës 6/1 të nenit 30 të këtij ligji.”

Neni 10

Titulli i Kreut VI ndryshon si vijon:

**“PROGRAMI PËR PËRSHTATJEN E OBJEKTEVE SHTETËRORE NË BANESA SOCIALE DHE PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË BANIMIT”**

Neni 11

Në nenin 40 bëhen këto ndryshime e shtesa:

1. Në fund të pikës 1, shtohet fjalia me këtë përbajtje:

“Objektet e kthyera në fond banese sipas këtij neni, ngelen në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe përdoren për programin e banesave sociale, sipas shkronjës “c”, të pikës 2 të nenit 17.”

2. Pika 3 riformulohet si vijon:

“3. Me përmirësim të kushteve të lagjeve të varfëra, kuptohet tërësia e punimeve që duhet të kryhen, me qëllim plotësimin e kushteve të parashikuara në shkronjat “ç” e “d” të nenin 4 të

këtij ligji sipas kushteve dhe kriterieve që përcaktohen në thirrjet që shpallen nga ministria përgjegjëse për strehimin në zbatim të buxhetit vjetor.

#### Neni 12

Në pikën 1 të nenit 41 hiqen fjalët “ose i kushteve deri në ndërtim të ri,”.

#### Neni 13

Neni 42 ndryshon si vijon:

1. Programi për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese realizohet nëpërmjet grantit konkurruesh për:

- a) përmirësimin e lagjeve të varfëra, sipas përcaktimit në pikën 52 të nenit 2 të këtij ligji;
- b) adaptimin e objekteve shtetërore të dala jashtë funksioni, me kusht që kostoja për metër katror për realizimin e investimit të mos jetë më e lartë se 80% e kostos së ndërtimit, të miratuar sipas shkronjës “dh” të nenit 72 të këtij ligji për njësinë e vetëqeverisjes vendore ku realizohet inëvstimi;
- c) përmirësimin e banesave të amortizuara dhe atyre në rrezik shembje, me kushtin që kostot e përmirësimit të mos janë më të larta se 50% e kostos së ndërtimit të një objekti të ri, sipas normave të strehimit”;

2. Kushtet, procedura e përfitimit dhe dhënia e granteve konkurruese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pas pikës 2 shtohet pika 3 si vijon:

“3. Kufinjtë e financimit për cdo projekt individual dhe masa e granteve për cdo familje përcaktohen në termat e referencës, që miratohen nga ministri përgjegjës për strehimin çdo vit para shpalljes së garës për grantin konkurruesh.

#### Neni 14

Në nenin 46, bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Pas shkronjës ç) të pikës 1, shtohet shkronja d) me këtë përbajtje:

“(d) të rinj dhe familje të reja, sipas përcaktimeve në nënndarjet iv) e v) të shkronjës b) të nenit 16 të këtij ligji që nuk disponojnë banesë në pronësi”.

2. Në fund të fjalisë së pikës 2 shtohet togfjalëshi “...që përfiton familja sipas normave të strehimit.”

#### Neni 15

Në nenin 47 “Subvencionimi i interesave të kredive” bëhen ndryshimet si vijon:

1. Në pikën 2 në fjalinë e fundit, pas togfjalëshit “Masa e subvencionimit të kredisë”, shtohet togfjalëshi “përveç rasteve të përcaktuara në pikat 2/1 e 2/2 të këtij neni.

2. Pas pikës 2 shtohen pikat 2/1, 2/2 e 2/3 me përbajtje si vijon:

“2/1 Përfitojnë kredi me interes të barabartë me 0 përqind:

- a) familjet që banojnë si qiramarrës në ish pronë private sipas Aktit Normativ Nr. 3, datë 1.3.2012;
- b) familjet e punonjësve të rendit të rënë në detyrë;

2/2 Përfitojnë kredi me interes të barabartë me 1,5% për banesën e parë, të rinj dhe familje të reja sipas përcaktimeve në nënndarjet iv) e v) të shkronjës b) të nenit 16 të këtij ligji.

2/3 Përfitojnë kredi me kushte lehtësuese edhe individë a familje që plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 1 dhe shkronjat “a” e “c” të pikës 1 të nenit 48 të këtij ligji, të cilët, për sigurimin e strehimit të tyre, kërkojnë të blejnë truall në njësinë e vetëqeverisjes vendore ku janë të regjistruar. Shuma maksimale e kredisë që ata përfitojnë është e njejtë me shumën e kredisë që do të përfitonin për blerjen e një banese me kosto të ulët në treg sipas këtij neni.

#### Neni 16

Në nenin 48 bëhen këto ndryshime e shtesa:

1. Pika e parë ndryshon si vijon:

“1. Përfitojnë nga programi i banesave me kosto të ulët individë e familje me të ardhura vjetore neto baraz ose më të ulta se 1/6 e vlerës mesatare të banesës në treg që përfiton individi a familja.”

2. Pas pikës 2, shtohet pika 2/1 me këtë përbajtje:

“2/1. Familjet që disponojnë banesë në pronësi nën normat e strehimit dhe aplikojnë për strehim, përfitojnë kredi me interesa të subvencionuar sipas nenit 47 të këtij ligji në masën jo më të madhe se 60% e cmimit mesatar të shiħblerjes së banesës në treg që miratohen me udhëzim të këshillit të ministrave, sipas shkronjës “dh” të nenit 72 të këtij ligji

#### Neni 17

Në nenin 49 pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përbajtje:

“2/1. Familja që përfiton banesë me kosto të ulët nga Enti Kombëtar i Banesave edhe kur e ka shlyer vlerën në mënyrë të menjëhershme duke u bërë pronare e saj, detyrohet te mos e shesë për një periudhe 15-vjeçare. Kur familja, për arsyte ndryshme, kërkon ta shesë banesën brenda këtij afati, ajo detyrohet t’ja shesë këtë banese Entit, me vlere jo me shume sesa vlera me te cilën është blere. Ky detyrim shënohet në kartelën e pasurisë të përcaktuar dhe në kontratën e lidhur mes palëve, sipas dispozitave të Kodit Civil (neni 660)

#### Neni 18

Në pikën 7 të nenit 50 hiqen fjalët “pa shpërblim”.

#### Neni 19

Neni 71 “Këshilli Kombëtar për Strehimin”, shfuqizohet.

#### Neni 20

Në nenin 72 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Shkronjat d) e dh) ndryshojnë si vijon:

“d) krijon bazën e të dhënavët në nivel vendor dhe kombëtar, në zbatim të pikës 1 të nenit 14 të këtij ligji, për:”

“dh) përcakton, nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave, koston mesatare vjetore të ndërtimit të banesave dhe vlerat mesatare të shitblerjes së banesave në treg, në kuadër të programeve të këtij ligji, e cila propozohet nga ministria përgjegjëse për strehimin dhe miratohet çdo 2 vjet me udhëzim të Këshillit të Ministrave.”

2. Shronja g) ndryshon si vijon:

“g) Zbaton, programe, sipas këtij ligji, nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave.

### Neni 21

Në nenin 73 “Funksionet e njësisë së vetëqeverisjes vendore” bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Shkronja e) riformulohet si më poshtë:

e) Krijon dhe përditëson bazën e të dhënavët të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, në nivel vendor.

2. Shkronja ë) shfuqizohet.

3. Pika 5 shfuqizohet.

### Neni 22

Pas nenit 73 shtohet Neni 73/1 “Monitorimi” me përbajtje si vijon:

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore i paraqesin Ministrisë përgjegjëse për strehimin, sa herë që kërkohet, por jo më pak se katër herë në vit, një raport mbi zbatimin dhe progresin për çdo program të strehimit social dhe cdo grup të pafavorizuar përfitues sipas ligjit. Mos paraqitja e ketij informacioni përbën shkas për mos përfshirjen e njësisë së vetëqeverisjes vendore në financimin a bashkëfinancimin e programeve të strehimit nga buxheti i shtetit.

2. Ministria përgjegjëse për strehimin monitoron zbatimin e programeve sociale të strehimit sipas këtij ligji, bazuar në raportimet periodike dhe vizita në terren, sipas metodologjisë që u bëhet e njojtur zyrtarisht nga ministri.

### Neni 23

Në Kreun XIV dispozitat e fundit pas neni 75 shtohen nenet 75/1, 75/2 si më poshtë:

#### Neni 75/1

Kundërvajtjet dhe masat administrative:

Në kuptim të këtij ligji, shkeljet e mëposhtme të konstatuara nga struktura përgjegjëse pranë ministrisë që mbulon strehimin, pavarësisht nëse përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

- Mos zbatimi i pikës 6 të nenit 4 të këtij ligji, kryetari i njësisë së vetë qeverisjes vendore dënohet me gjobë nga nëpunësi i parë autorizues e cila varion nga 2-4 paga mujore.
- Për mos zbatim të parashikimit të pikës 4 të nenit 6 të këtij ligji, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dënohet nga nëpunësi i parë autorizues, me gjobë sa 10% e kostos

- së sipërfaqes së ndërtimit të pa përfstuar.
- c) Mos zbatimi i nenit 73/1 të këtij ligji nëpunësi autorizues dhe/ose nëpunësi zbatues i një njësisë dënohen me gjobë nga nëpunësi i parë autorizues, sa 1 pagë mujore.
  - d) Në zbatim të këtij nenit, “nëpunës i parë autorizues” është nëpunësi i përcaktuar në pikën 41 të nenit 3, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 75/2

Ekzekutimi dhe ankimimi i vendimeve

- a) Procedurat e konstatimit, të shqyrtimit, ankimit dhe ekzekutimit të kundërvajtjeve administrative, janë ato të parashikuara në ligjin për kundërvajtjet administrative
- b) Personi ndaj të cilit është vodosur sanksioni administrativ, brenda 45 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, mund të bëjë ankim në gjykatë, në përputhje me ligjin për kundërvajtjet administrative.
- c) Masa e dënimit, e përcaktuar me gjobë, mund të shlyhet me këste mujore. Këstet mujore shlyhen sipas përcaktimeve të ligjit për kundërvajtjet administrative.
- d) Gjobat ekzekutohen, përkatësisht, nga zyra e financës së njësisë së vetëqeverisjes vendore ~~në të cilën paguhet personi ndaj të cilit është vodosur sanksioni administrativ dhe derdhen në buxhetin e njësisë së qeverisjes qendrore.~~

Neni 24

Në nenin 77 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshon si më poshtë:

“1. Privatizimi i banesave apo objekteve të kthyera në fond banese bëhet bazuar në sipërfaqet e banimit, të përcaktuara për normat e strehimit, sipas çertifikatës familjare në momentin kur i ka lindur e drejta e privatizimit për shkak të miratimit të një organi publik. Çdo sipërfaqe e përfituar mbi atë të normave të strehimit do të llogaritet me koston aktuale të ndërtimit. Këtu përfshihen:”

2. Shkronja ç) ndryshon si vijon:

“ç). Banesat dhe objektet e kthyera në fond banesë me vendime të Këshillit të Ministrave, përpëra hyrjes në fuqi të ligjit 22/2018 “Për strehimin social”, të cilat kanë kaluar në administrim Entit Kombëtar të Banesave me qëllim privatizimin e tyre.

3. Pika 5 ndryshon si më poshtë:

“5. “Familjet e shpërndalura nga ndërtimi i hidrocentralit të Fierzës si edhe familjet e trajtuarë për meremetime baneshash, të cilat kanë përfituar kredi nga buxheti i shtetit nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave sipas listës emërore që disponohet nga ky i fundit, bazuar në aktet nënligjore të renditura në shtojcën 1 të këtij ligji, u falen detyrimet monetare”.

4. Pika 7 ndryshon si më poshtë:

“7. Banesat e ndërtuara me fonde publike nga Enti Kombëtar i Banesave ose të transferuara

nëga të tretë tek enti, të cilat nuk janë pajisur me dokument pronësie, trajtohen sipas legjislacionit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në republikën e Shqipërisë, nga ASHK, dhe regjistrohen në emër të Entit. Në rastet kur mungon dokumentacioni i kolaudimit të objekteve, ai përgatitet nga Enti Kombëtar i Banesave dhe i bashkëlidhet dokumentacionit që kërkohet nga ASHK për procesin e legalizimit. Pas regjistrimit dhe pajisjes me certifikatat e pronësisë, Enti kryen procedurat e privatizimit sipas aktit nënligjor që miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Pas pikës 7, shtohet pika 7/1 me këtë përbajtje:

“7/1. Të gjitha objektet që trajtohen sipas këtij nenit, përjashtohen nga detyrimi për sigurimin e objektit për raste fatkeqësie natyrore.

6. Në pikën 9 bëhen këto ndryshime e shtesa:

1. Në fjalinë e dytë, hiqet paragrafi “deri në dy vjet nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Pas fjalisë së fundit, shtohet fjalia me këtë përbajtje:

“Familjet e minoritetit Rom e Egjiptian që trajtohen me subvencionimin e qirasë së banesës në tregun e lirë, përjashtohen nga detyrimi për paraqitjen e kontratës së qirasë, të nënshkruar tek noteri për një afat 5-vjeçar nga hyrja në fuqi e ndryshimeve të ligjit 22/2018. Në mungesë të kontratës së qirasë të noterizuar, njësitë e vetëqeverisjes vendore, sigurohen që familjet që i përkasin këtij grapi, të kenë siguruar strehim në një banesë me qira.

Neni 25

Ngarkohet Këshilli i Mistrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 3,6,13,20 të këtij ligji.

Neni 26

Hyrja në fuqi e ndryshimeve ligjore

Ky ligj hyn në fuqi \_\_\_\_ muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

**Lindita NIKOLLA**

Miratuar në datën \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

## **SHTOJCA 1**

### **Dekreti i Presidentit të Republikës Nr.886, datë 12.07.1994**

*“Për dhënie kredie banorëve të zonave të përmbytura nga ndërtimi i hidrocentraleve në rrethet Kukës, Has, Tropojë dhe Pukë”*

### **Udhëzimi Nr.1, datë 20.02.1995**

*“Për kriteret e dhënies së kredive banorëve të zonave të përmbytura nga ndërtimi i hidrocentraleve në rrethet Kukës, Has, Tropojë e Pukë”*

### **VKM Nr.306, datë 30.06.1994**

*“Për masat që do të merren për zonat ë përmbytyra nga ndërtimi i hidrocentraleve në rrethet Kukës, Has, Tropojë e Pukë”*

---

### **VKM Nr.716, datë 18.02.1995**

*“Për sistemimin e familjeve të fshatit Fajzë të rrethit Has në tokat disponibël të Kurorës së Tiranës”*

### **VKM Nr.253, datë 30.04.1998**

*“Për përdorim fondi për familjet e rretheve Kukës e Has të përmbytura nga hidrocentral, si dhe për financimin e ndërtimit të apartamenteve, për familjet që do të shpërndulen nga fshati Mërraj”*

### **VKM Nr.413, datë 27.07.2000**

*“Për trajtimin e problemeve të ngritura nga familjet që janë përmbytur nga tokat nga ujëmbledhësi i hidrocentralit të Fierzës”*

### **VKM Nr.14, datë 08.01.1996**

*“Për dhënie kredie për ndërtim baneshash në Kamicë të Komunës qëndër të rrethit të Malësisë së Madhe”*

### **VKM Nr.504, datë 25.09.1995**

*“Për përballimin e dëmeve nga përmbytjet e muajit shtator të vitit 1995”*

### **VKM Nr.54, datë 30.01.1995**

*“Për sistemimin e dhënie kredie familjeve të fshatrave Sharrë e Murrizë të rrethit Tiranë, 37 familjeve të Bashkisë së Kukësit dhe 5 familjeve të Komunës së Bushtricës, 2 familjeve të Komunës së Belshit në rrethin e Elbasanit, 1 familjeje të Bashkisë së Ballshit, 7 familjeve të Komunës së Vreshasit në rrethit e Korçës dhe 5 familjeve të rrethit të Librazhdit”*

### **VKM Nr.625, datë 23.10.1995**

*“Për shpërndarje fondesh për investime”*

**VKM Nr.4, datë 10.01.1996**

**(Nuk e kemi gjetur dot titullin e aktit)**

---

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 22/2018 “PËR STREHIMIN  
SOCIAL”**